




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION




Radio Televizioni i Kosovës

Emri i OSHMA-së: Radio Kosva 1 dhe Radio Kosova 2

Drejtor: Ernest LUMA

Adresa: Rr. Xhorxh Bush, Nr. 14, Prishtinë



VENDIM

për ndarjen e frekuencave shtesë për Radio Kosova 1 dhe Radio Kosova 2, me seli në Prishtinë

Fakte

1. Komisioni i Pavarur për Media (KPM), është organ i pavarur i cili është kompetent për rregullimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e spektrit të frekuencave të transmetimit. KPM-ja rregullon të drejtat, detyrimet si dhe përgjegjësitë e personave fizik dhe juridik të cilët ofrojnë shërbimet mediale audio dhe audiovizuale.
2. Radio Kosova 1 dhe Radio Kosova 2 janë Ofrues të Shërbimeve Mediale Audio (Radio), me mbulim nacional, të licencuara nga Komisioni i Pavarur i Mediave për transmetim tokësorë të radio programeve, në kuadër të transmetuesit publik – Radio Televizionit të Kosovës – RTK, me seli në Prishtinë.
3. Më datë 6 janar 2021, Radio Kosova 1 dhe Radio Kosova 2 kanë parashtruar, në zyrën Ekzekutive të KPM-së, një kërkesë për frekuenca shtesë në brezin FM për mbulimin e rajoni e Komunës së Kamenicës, nga pika e transmetimit në Kranidell.

Arsyetim

4. Komisioni konstaton se arsyeja e kërkesës, për dy frekuenca shtesë në brezin FM për Radio Kosova 1 dhe Radio Kosova, është zgjerimi i mbulueshmërisë të territorit të Republikës së Kosovës dhe ofrimi i sinjalit kualitativ, në këtë rast mbulueshmëri më të mirë me sinjal audio të Komunës së Kamenicës.
5. Komisioni konstaton se, pas pranimit të kësaj kërkesë për frekuenca shtesë, zyrtarët e Departamentit të Menaxhimit të Frekuencave (DMF), në kuadër të Zyrës Ekzekutive të KPM-së, me qëllim të vlerësimit të gjendjes së brezit frekuencor dhe identifikimin e frekuencave të lira, më datën 13 janar 2021 dhe më datën 20 janar 2021, kanë vizituar lokacionin e theksuar në kërkesë dhe kanë kryer matjet e nevojshme teknike. Në bazë të

këtyre matjeve dhe vlerësimin të planit frekuencor të KPM-së, është konstatuar se ka frekuenca të lira për ti ofruar Radio Kosova 1 dhe Radio Kosova 2 për mbulimin e kësaj zone dhe se nuk ka asnjë pengesë teknike për këtë çështje, me përjashtim që mund të ketë ndërhyrje të dobëta në frekuenca nga vendet fqinje, duke marrë parasysh që Komuna e Kamenicës është lokacion kufitar.

6. Komisioni konstaton se, se ndarja e dy frekuencave shtesë për Radio Kosova 1 dhe Radio Kosova 2, me qëllim të përmirësimit të sinjalit, që ai të jetë më kualitativë dhe rritjen e mbulueshmërisë së territorit dhe popullsisë së Republikës së Kosovës është në interes publik dhe në pajtim me misionin e transmetuesit publik.
7. Komisioni vlerëson se kërkesa është bërë në pajtim me procedurat e KPM-së, të bazuara në Ligjin dhe aktet nënligjore të KPM-së dhe si e tillë i plotëson kriteret për miratim.

Vendim

8. Komisioni në takimin e tij të mbajtur me datën 16 mars 2021, merr vendim për miratimin e kërkesës për ndarjen e dy frekuencave shtesë, në brezin FM, një për Radio Kosova 1 dhe tjetra për Radio Kosova 2, për mbulueshmëri më të mire dhe me sinjal kualitativ të Komunës së Kamenicës nga pika e transmetimit, siç është cekur në kërkesë.
9. Këtë vendim e lëshon Komisioni, dhe i njëjti lyp në fuqi nga data e nënshkrimit.


Xhevat LATIFI

Kryetar

Komisioni i Pavarur i Mediave



16.03.2021

datë